

22 -03- 2021

Ref. 2103/367/BA/yf



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Nr.08/2021

Bordi për Ankesa, i përbërë nga Ylber Fetahaj, kryetar dhe Avdyl Hyseni e Ilaz Rudaku anëtarë, lidhur me Ankesën me numër Ref:2102/226/KPM/xh.l të datës 24.02.2021 të parashtruesit “Telkos” L.L.C. të paraqitur ndaj Vendimit Ref:2102/080/KPM/xhl, të datës 28.01.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar Ankesa Ref:2102/226/KPM/xh. e datës 24.02.2021 e parashtruesit “Telkos” L.L.C dhe mbetet në fuqi Vendimi Ref:2102/080/KPM/xhl, i datës 28.01.2021 i Komisionit të Pavarur të Mediave.

A r s y e t i m

Komisioni i Pavarur i Mediave me Vendimin Ref:2102/226/KPM/xhl, e datës 28.01.2021 e ka refuzuar Ankesën e palës “Telkos” përmes të cilës pretendohet se OSHMA Klan Kosova ka vepruar në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Kundër këtij Vendimi në afatin e paraparë ligjor “Telkos” me datën 24.02.2021 ka parashtruar Ankesë Ref:2102/226/KPM/xh. me datën 24.02.2021 pranë Bordit për Ankesa, për shkak të: vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, sepse në Vendim të KPM-së është konstatuar se Klan Kosova e ka paraqitur ofertën tek operatori “Telkos”, fakt ky i cili nuk qëndron, sepse një ofertë e tillë është ofruar nga Artmotion për pakon e tij programore dhe nuk është ofruar mundësi të lidhet marrëveshje me Klan Kosovën, siç e përcakton Rregullorja KPM-2020/01 në nenin 10, dhe për zbatim të gabuar të së drejtës materiale për faktin se Klan Kosova ka vepruar në pajtim me nenin 10 pika 2 të Rregullores KPM-2020/01 ka bërë diskriminim për faktin se nuk kemi trajtim të barabartë të operatorëve karshi Artmotion dhe IPKO.

Bordi për Ankesa, në seancën e mbajtur me datën 12.03.2021 ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha pretendimet ankimore të Palës ankuese “Telkos”, si dhe ka analizuar të gjitha provat tjera të cilat kanë rezultuar me marrjen e Vendimit Ref: 2102/080/KPM/xhl, të datës 28.01.2021 të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Bordi për Ankesa konstaton se pretendimet e Palës ankuese lidhur me gjendjen faktike dhe zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe shkeljen ligjore nga ana e Komisionit të Pavarur të Mediave, janë të pa bazuara sepse Komisioni i Pavarur i Mediave, me rastin e marrjes së Vendimit të kundërshtuar e ka vlerësuar plotësisht gjendjen faktike, pasi që me miratimin e Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e OSHMA-ve është përcaktuar në nenin 10 pika 1 se: “*OSHMA-të të cilët nuk gëzojnë statusin e bartjes së obligueshme, mund të barten nga operatorët e shpërndarjes vetëm në bazë të marrëveshjes valide*”. Ndërsa, sa i përket pretendimit për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale për pretendimet së Klan Kosova ka bërë diskriminim, janë pretendime të cilat nuk qëndrojnë, pasi që është vërtetuar fakti se operatori IPKO me Klan Kosovën kanë marrëveshje valide dhe se OSHMA Klan Kosova i ka përcjellë ofertë të gjithë operatorëve të shpërndarjes për të arritur marrëveshje valide në mes tyre.

Bordi për Ankesa konstatoi që Vendimi i KPM-së është marrë duke u bazuar në dispozitat materiale, përkatësisht në pajtim me nenin 10 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores KPM-2020/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale si dhe dispozitat procedurale.

Andaj Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartcekura, si dhe bazuar në nenin 44 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, si dhe nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores BA-2018/01 të Punës së Bordit për Ankesa, vendosi unanimisht si në dispozitivin e këtij Vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi mund të nicohet konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:
-Palëve dhe
-Arkivit të KPM-së.




Ylber Fetahaj
Kryetar i Bordit për Ankesa